



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Tiranë, më datë 07.05.2019

Nr. 171 Prot.

VENDIM

Nr.144 , datë 07.05.2019

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2 dhe neni 72, pika 1, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.786, datë 26.12.2018 për miratimin e "Zonave Arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre", Neni 3, pika d, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 07.05.2019, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit: "Rikonstrukcion me rindërtim "Banesë dhe shërbime 3 kate", Lagjja Nr. 1, Rruga "Tregëtare", në zonë arkeologjike "A", Durrës, në pronësi të Z. Gentjan Spiru;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 72, pika 1;
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

Arta Dollani

KRYETAR

Elva MARGARITI

